



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNEVE TË BRËNDËSHME

Drejtoria e Përgjithshme
e Policisë së Shtetit

Nr. _____ Prot, datë 28.06.2014



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËVE TË BRËNDËSHME

Drejtoria e Përgjithshme
e Policisë së Kosovës

Nr. _____ Prot, datë 28.06.2014



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

PËR

ORGANIZIMIN E SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA TË POLICIMIT RRUGOR
TË POLICISË SË SHTETIT SHQIPTAR DHE POLICISË SË KOSOVËS,
NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Policia e Shtetit, Shqipëri, këtej e tutje *pala pritëse*, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Zoti Artan DIDI, dhe Policia e Kosovës, këtej e tutje *pala dërguese*, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Zoti Shpend MAXHUNI:

Të **vetëdijshëm** për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit mes dy agjencive policore në përpjekje për rritjen e elementëve të Sigurisë Rrugore;

Të **ndërgjegjshëm** për faktin se gjatë sezonit turistik Qershor - Shtator 2014, ka një rritje të ndjeshme të numrit të shtetasve nga Kosova që vijnë për pushime në zonat turistike të Shqipërisë, si dhe të mjeteve që qarkullojnë në akset kryesore rrugore që lidhin të dy vendet;

Me **synim** intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe për të forcuar bashkëpunimin midis policive të dy vendeve, nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të masave të përbashkëta;

Me **qëllim** vendosjen e bashkëpunimit konkret në fushën e parandalimit të kundërvajtjeve administrative, për rritjen e efikasitetit të luftës ndaj humbjes së jetëve njerëzore në aksidentet rrugore dhe zbatimin me rigorozitet të legjislacionit rrugor, për krijimin e një ambienti më të sigurt për të gjithë qytetarët dhe përdoruesit e rrugës, që qarkullojnë në akset rrugore që lidhin dy vendet;

Me dëshirën për të mundësuar arritjen e synimeve të sipërpërmendura nëpërmjet një bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërpolicor;

Bazuar në ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin "Për Policinë" nr. 04/L-076, i datës 02 Mars 2012 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

bien dakord si më poshtë:

Neni 1.

Pala dërguese dërgon gjashte (6) punonjës policie të trafikut rrugor dhe tre (3) automjete të Policisë së Kosovës në Shqipëri, për periudhën 01.07.2014 deri me 31.08.2014, në periudha jo më të shkurtra se 10 (dhjetë) ditë.

Oficerët e Policisë Rrugore te *palës dërguese* së bashku me oficeret e Policisë Rrugore te *palës pritëse* do të marrin pjesë në aktivitete dhe intensifikojnë bashkëpunimin sa më cilësor policor, me qëllim:

- a) shkëmbimin e praktikave me te mira te policimit rrugor,
- b) mbështetjen në parandalimin e ngjarjeve aksidentale me pasoja për jetën e qytetareve,
- c) forcimin e sigurisë rrugore,
- d) ndëshkimin e shkeljeve te rregullave te qarkullimit rrugor,

Oficeret e *palës dërguese* gjatë qëndrimit në Shqipëri dhe gjatë kryerjes së aktiviteteve në funksion të detyrave funksionale të tyre, nuk kane kompetenca policore ekzekutive, dhe nuk mund të ndër marrin aktivitete për të cilat është kompetent oficeri i *palës pritëse*.

Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, oficerët e *palës dërguese*, do të jenë me uniformën policore të Policisë së Kosovës.

Personeli Policor të jetë i kompletuar me uniformë dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e shërbimit.

Neni 2

Pala pritëse do të njohë oficeret e *palës dërguese* me rregullat përkatëse të ligjshmërisë kombëtare dhe kushtet specifike të punës së shërbimit te Policisë Rrugore gjatë sezonit turistik.

Neni 3.

Planifikimi i oficereve te *palës dërguese* ne shërbim kryhet nga strukturat drejtuese të Drejtorisë së Policisë Qarkut ku do të vendoset me shërbim, në përputhje me rregullat e organizimit të këtij shërbimi.

Në raste urgjente, oficerët e *palës dërguese* duhet të jetë në gatishmëri për kryerjen e detyrave në çdo kohë të ditës.

Të gjitha vërejtjet e oficerëve të *palës dërguese* do t'i trajtojë shërbimi i autorizuar i *palës pritëse*, në pajtim me legjislacionin kombëtar.

Neni 4

Gjatë kryerjes së detyrave, *pala pritëse* do t'i ofrojë oficerëve të *palës dërguese* mbrojtjen dhe ndihmën e barabartë, si të ishte oficer i Policisë Shqiptare.

Pala pritëse do të sigurojë për oficerët e *palës dërguese* vendbanim, ushqim dhe transport lokal falas si dhe karburant për automjetet e Policisë së Kosovës gjatë kohës së shërbimit në Shqipëri.

Gjatë kryerjes së shërbimit në territorin e Republikës së Shqipërisë oficerët e *palës dërguese* janë përgjegjës për veprimet që kryejnë në lidhje me statusin juridik në punë dhe përgjegjësinë për dëmin dhe ndëshkohet sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 5

Të gjitha detyrat të cilat kryhen nga oficerët e *palës dërguese*, koordinohen nga *pala pritëse*, konkretisht nga drejtuesi i Sektorit të Policisë Rrugore kompetente në territor.

Oficerët e *palës dërguese* për punën që kryejnë janë përgjegjës para eprorit të shërbimit të *palës dërguese*.

Neni 6

Pala pritëse është përgjegjëse për të gjitha çështjet administrative lidhur me detyrat të cilat kryhen nga oficerët e *palës dërguese* në Shqipëri gjatë periudhës së shërbimit.

Neni 7

Pala pritëse, në bazë të mendimit të njësisë organizative kompetente, mund të ndërpresë qëndrimin në Shqipëri të oficerëve të *palës dërguese* për shkak:

- a) të moskryerjes së detyrave në mënyrë efikase, pa dinjitet dhe në mënyrë jo të duhur;
- b) të sjelljes në kundërshtim me etikën profesionale.

Raporti përkatës në lidhje me ndërprerjen e qëndrimit i bazuar në fakte objektive, policia shqiptare i'a dërgon *palës dërguese*.

Neni 8

Pala pritëse në zbatim të udhëzimit Ministrit të Rendit Publik nr. 1288, datë 09.08.2000 "Për mënyrën e dhënies, heqjes, administrimit dhe ruajtjes së armëve e municioneve luftarake, sportive dhe të gjahut të dhëna me leje" i ndryshuar, u lejon hyrjen anëtarëve të

shërbimit të forcës policore të *palës dërguese* sipas listës së poshtëshënuar në vendin tonë.

| Nr | Emër Mbiemër | Nr.Letërnjoftimit | Lloji i armës | Nr.armës | Sasia e municionit | Targa e mjetit |
|----|--------------|-------------------|---------------|----------|--------------------|----------------|
| 1 | | | | | | |
| 2 | | | | | | |
| 3 | | | | | | |
| 4 | | | | | | |
| 5 | | | | | | |
| 6 | | | | | | |

Neni 9

Pala pritëse bën vlerësimin e nevojës së vazhdimit të bashkëpunimit policor lidhur me dërgimin e përkohshëm të oficerëve të *palës dërguese* në Shqipëri gjatë sezonit turistik.

Vendimin lidhur me vazhdimin e bashkëpunimit të ardhshëm në këtë fushë, *pala pritëse* do t'a dërgojë *palës dërguese* jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë, përpara ditës së ndërprerjes së dërgimit të përkohshëm të oficerëve të *palës dërguese*.

Neni 10

Ndryshimi apo plotësimi i mundshëm i këtij memorandumi bëhet me pëlqimin e palëve. Përfaqësuesit teknik mes palëve janë Drejtorët e Policisë Rrugore përkatës.

Mosmarrëveshjet, të cilat rrjedhin gjatë zbatimit të këtij protokoli, do të zgjidhen me mirëkuptim.

Ky protokoll hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe e humbet fuqinë ditën e gjashtëdhjetë (60) pas përfundimit të periudhës së caktuar në nenin 1 paragrafi 1 të këtij Protokoli.

Neni 11

Nënshkruar në 28.06.2014, në katër kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, ku të gjitha tekstet janë identike.

Për Policinë e Shtetit, Shqipëri

Artan DIDI

Drejtor i Përgjithshëm

Për Policinë e Kosovës

Shpend MAXHUNI

Drejtor i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNEVE TË BRËNDËSHME

Drejtoria e Përgjithshme
e Policisë së Shtetit

Nr. ____ Prot, datë __. 06. 2014



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËVE TË BRËNDËSHME

Drejtoria e Përgjithshme
e Policisë së Kosovës

Nr. ____ Prot, datë __. 06. 2014

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

PËR

ORGANIZIMIN E SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA TË POLICIMIT RRUGOR
TË POLICISË SË SHTETIT SHQIPTAR DHE POLICISË SË KOSOVËS,
NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Policia e Shtetit, Shqipëri, këtej e tutje *pala pritëse*, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Zoti Artan DIDI, dhe Policia e Kosovës, këtej e tutje *pala dërguese*, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Zoti Shpend MAXHUNI:

Të vetëdijshëm për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit mes dy agjencive policore në përpjekje për rritjen e elementëve të Sigurisë Rrugore;

Të ndërgjegjshëm për faktin se gjatë sezonit turistik Qershor - Shtator 2014, ka një rritje të ndjeshme të numrit të shtetasve nga Kosova që vijnë për pushime në zonat turistike të Shqipërisë, si dhe të mjeteve që qarkullojnë në akset kryesore rrugore që lidhin të dy vendet;

Me synim intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe për të forcuar bashkëpunimin midis policive të dy vendeve, nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të masave të përbashkëta;

Me qëllim vendosjen e bashkëpunimit konkret në fushën e parandalimit të kundërvajtjeve administrative, për rritjen e efikasitetit të luftës ndaj humbjes së jetëve njerëzore në aksidentet rrugore dhe zbatimin me rigorozitet të legjislacionit rrugor, për krijimin e një ambienti më të sigurt për të gjithë qytetarët dhe përdoruesit e rrugës, që qarkullojnë në akset rrugore që lidhin dy vendet;

Me dëshirën për të mundësuar arritjen e synimeve të sipërpërmendura nëpërmjet një bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërpoligor;

Bazuar në ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin "Për Policinë" nr. 04/L-076, i datës 02 Mars 2012 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

bien dakord si më poshtë:

Neni 1.

Pala dërguese dërgon gjashtë (6) punonjës policie të trafikut rrugor dhe tre (3) automjete të Policisë së Kosovës në Shqipëri, për periudhën 01.07.2014 deri me 31.08.2014, në periudha jo më të shkurtra se 10 (dhjetë) ditë.

Oficerët e Policisë Rrugore te *palës dërguese* së bashku me oficeret e Policisë Rrugore te *palës pritëse* do të marrin pjesë në aktivitete dhe intensifikojnë bashkëpunimin sa më cilësor policor, me qëllim:

- a) shkëmbimin e praktikave me të mira të policimit rrugor,
- b) mbështetjen në parandalimin e ngjarjeve aksidentale me pasoja për jetën e qytetareve,
- c) forcimin e sigurisë rrugore,
- d) ndëshkimin e shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor,

Oficeret e *palës dërguese* gjatë qëndrimit në Shqipëri dhe gjatë kryerjes së aktiviteteve në funksion të detyrave funksionale të tyre, nuk kanë kompetenca policore ekzekutive, dhe nuk mund të ndërmarrin aktivitete për të cilat është kompetent oficeri i *palës pritëse*.

Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, oficerët e *palës dërguese*, do të jenë me uniformën policore të Policisë së Kosovës.

Personeli Policor të jetë i kompletuar me uniformë dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e shërbimit.

Neni 2

Pala pritëse do të njohë oficeret e *palës dërguese* me rregullat përkatëse të ligjshmërisë kombëtare dhe kushtet specifike të punës së shërbimit të Policisë Rrugore gjatë sezonit turistik.

Neni 3.

Planifikimi i oficerëve të *palës dërguese* në shërbim kryhet nga strukturat drejtuese të Drejtorisë së Policisë Qarkut ku do të vendoset me shërbim, në përputhje me rregullat e organizimit të këtij shërbimi.

Në raste urgjente, oficerët e *palës dërguese* duhet të jetë në gatishmëri për kryerjen e detyrave në çdo kohë të ditës.

Të gjitha vërejtjet e oficerëve të *palës dërguese* do t'i trajtojë shërbimi i autorizuar i *palës pritëse*, në pajtim me legjislacionin kombëtar.

Neni 4

Gjatë kryerjes së detyrave, *pala pritëse* do t'i ofrojë oficerëve të *palës dërguese* mbrojtjen dhe ndihmën e barabartë, si të ishte oficer i Policisë Shqiptare.

Pala pritëse do të sigurojë për oficerët e *palës dërguese* vendbanim, ushqim dhe transport lokal falas si dhe karburant për automjetet e Policisë së Kosovës gjatë kohës së shërbimit në Shqipëri.

Gjatë kryerjes së shërbimit në territorin e Republikës së Shqipërisë oficerët e *palës dërguese* janë përgjegjës për veprimet që kryejnë në lidhje me statusin juridik në punë dhe përgjegjësinë për dëmin dhe ndëshkohet sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 5

Të gjitha detyrat të cilat kryhen nga oficerët e *palës dërguese*, koordinohen nga *pala pritëse*, konkretisht nga drejtuesi i Sektorit të Policisë Rrugore kompetente në territor.

Oficerët e *palës dërguese* për punën që kryejnë janë përgjegjës para eprorit të shërbimit të *palës dërguese*.

Neni 6

Pala pritëse është përgjegjëse për të gjitha çështjet administrative lidhur me detyrat të cilat kryhen nga oficerët e *palës dërguese* në Shqipëri gjatë periudhës së shërbimit.

Neni 7

Pala pritëse, në bazë të mendimit të njësisë organizative kompetente, mund të ndërpresë qëndrimin në Shqipëri të oficerëve të *palës dërguese* për shkak:

- a) të moskryerjes së detyrave në mënyrë efikase, pa dinjitet dhe në mënyrë jo të duhur;
- b) të sjelljes në kundërshtim me etikën profesionale.

Raporti përkatës në lidhje me ndërprerjen e qëndrimit i bazuar në fakte objektive, policia shqiptare i`a dërgon *palës dërguese*.

Neni 8

Pala pritëse në zbatim të udhëzimit Ministrit të Rendit Publik nr. 1288, datë 09.08.2000 "Për mënyrën e dhënies, heqjes, administrimit dhe ruajtjes së armëve e municioneve luftarake, sportive dhe të gjahut të dhëna me leje" i ndryshuar, u lejon hyrjen anëtarëve të

shërbimit të forcës policore të *palës dërguese* sipas listës së poshtëshënuar në vendin tonë.

| Nr | Emër Mbiemër | Nr.Letërnjoftimit | Lloji i armës | Nr.armës | Sasia e municionit | Targa e mjetit |
|----|--------------|-------------------|---------------|----------|--------------------|----------------|
| 1 | | | | | | |
| 2 | | | | | | |
| 3 | | | | | | |
| 4 | | | | | | |
| 5 | | | | | | |
| 6 | | | | | | |

Neni 9

Pala pritëse bën vlerësimin e nevojës së vazhdimit të bashkëpunimit policor lidhur me dërgimin e përkohshëm të oficerëve të *palës dërguese* në Shqipëri gjatë sezonit turistik.

Vendimin lidhur me vazhdimin e bashkëpunimit të ardhshëm në këtë fushë, *pala pritëse* do t'a dërgojë *palës dërguese* jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë, përpara ditës së ndërprerjes së dërgimit të përkohshëm të oficerëve të *palës dërguese*.

Neni 10

Ndryshimi apo plotësimi i mundshëm i këtij memorandumi bëhet me pëlqimin e palëve. Përfaqësuesit teknik mes palëve janë Drejtorët e Policisë Rrugore përkatës.

Mosmarrëveshjet, të cilat rrjedhin gjatë zbatimit të këtij protokoll, do të zgjidhen me mirëkuptim.

Ky protokoll hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe e humbet fuqinë ditën e gjashtëdhjetë (60) pas përfundimit të periudhës së caktuar në nenin 1 paragrafi 1 të këtij Protokoll.

Neni 11

Nënshkruar në 06.2014, në katër kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, ku të gjitha tekstet janë identike.

Për Policinë e Shtetit, Shqipëri

Artan DIDI

Drejtor i Përgjithshëm

Për Policinë e Kosovës

Shpend MAXHUNI

Drejtor i Përgjithshëm